

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



91 Nr./Br. 01110-8185  
Data/Datum 31.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2022

Datë: 30.03.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, , nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, si dhe nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për Themelimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale – byfet në shkolla, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale byfet në shkolla, në parcelat si vijon:

- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-01166-1 në sipërfaqe prej 26.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e SHME “Kadri Kusari” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-02130 në sipërfaqe prej 12.60 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë -Qytet, në objektin e SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705037-00293-1 në sipërfaqe prej 12.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, në objektin e SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-00468-1 në sipërfaqe prej 40.49 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë;
- Pronën e evidentuar në parcelat me nr. P-70705029-00066-2-002130 në sipërfaqe prej 32.00 m<sup>2</sup>, e evidentuar në zonën kadastrale Gjakovë Qytet, në objektin e SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë,  
**me këtë përbërje:**

1. z. Kosovar Alija, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
2. znj. Adelina Shehu – Kola, përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës .
3. znj. Teuta Pallaska-Milla, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
4. z. Mustafa Domi, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
5. z. Idriz Daci, përfaqësues i sektorit jo qeveritar .

1. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
  - Anëtareve të Komisioni
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Arbënësja Ikuqi